

**LIGJ**  
**Nr.10 310, datë 26.7.2010**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 190, DATË 26.11.2009 “PËR BUXHETIN E VITIT 2010”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 46 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 1**

Buxheti për vitin 2010 është:

|             |                       |
|-------------|-----------------------|
| Të ardhurat | 333 658 milionë lekë; |
| Shpenzimet  | 371 767 milionë lekë; |
| Deficiti    | 38 109 milionë lekë.  |

Ai përbëhet nga Buxheti i Shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

**Neni 2**

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 2**

Buxheti i shtetit, për vitin 2010, është:

|             |                        |
|-------------|------------------------|
| Të ardhurat | 264 283 milionë lekë;  |
| Shpenzimet  | 302 392 milionë lekë;  |
| Deficiti    | 38 109 milionë lekë.”. |

**Neni 3**

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 3**

Buxheti vendor, për vitin 2010, është:

|                                             |                        |
|---------------------------------------------|------------------------|
| Të ardhurat                                 | 30 395 milionë lekë;   |
| Nga të cilat:                               |                        |
| - Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror | 14 916 milionë lekë    |
| - Shpenzimet                                | 30 395 milionë lekë.”. |

#### Neni 4

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore, për vitin 2010, është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

|                                      |                      |
|--------------------------------------|----------------------|
| Të ardhurat, gjithsej                | 74 497 milionë lekë; |
| Nga të cilat:                        |                      |
| - kontributet                        | 46 282 milionë lekë; |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit | 28 215 milionë lekë; |
| Shpenzimet                           | 74 497 milionë lekë. |

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe kategori specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transfertat e Buxhetit të Shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2010, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar:

|                                      |                       |
|--------------------------------------|-----------------------|
| Të ardhurat, gjithsej                | 4 922 milionë lekë;   |
| Nga të cilat:                        |                       |
| - kontributet                        | 200 milionë lekë;     |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit | 4 722 milionë lekë;   |
| Shpenzimet                           | 4 922 milionë lekë.”. |

#### Neni 5

Neni 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

#### “Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore, për vitin 2010, është:

|                                                                                          |                      |
|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Të ardhurat, gjithsej                                                                    | 25 649 milionë lekë; |
| Nga të cilat:                                                                            |                      |
| - kontributet dhe të tjera                                                               | 6 014 milionë lekë;  |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit                                                     | 19 635 milionë lekë; |
| Shpenzimet                                                                               | 25 649 milionë lekë. |
| Fondi për shërbimin spitalor ndahet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.”. |                      |

#### Neni 6

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve, për vitin 2010, është:

|                                      |                       |
|--------------------------------------|-----------------------|
| Të ardhurat, gjithsej                | 1 700 milionë lekë;   |
| Nga të cilat:                        |                       |
| - të ardhura të tjera                | 1 400 milionë lekë;   |
| - transferimet nga Buxheti i Shtetit | 300 milionë lekë;     |
| Shpenzimet                           | 1 700 milionë lekë.”. |

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

|                        |                        |
|------------------------|------------------------|
| Grantet                | 6 310 milionë lekë;    |
| Të ardhurat tatimore   | 229 709 milionë lekë;  |
| Të ardhurat jotatimore | 28 264 milionë lekë.”. |

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 38 109 milionë lekë, nga i cili 300 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm dhe të huaj, prej 46 468 milionë lekësh, nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Kufiri i huamarrjes së brendshme dhe të jashtme mund të reduktohet për çdo të ardhur të arkëtuar nga privatizimet strategjike në masën 50 për qind të të ardhurave të realizuara nga ky privatizim. Pjesa tjetër e të ardhurave nga ky privatizim përdoret nga Këshilli i Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, i cili, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenet 1 e 2 të këtij ligji.”.

Neni 9

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

|                                         |                       |
|-----------------------------------------|-----------------------|
| Shpenzimet korrente                     | 226 839 milionë lekë; |
| Shpenzimet kapitale                     | 66 045 milionë lekë;  |
| Fondi rezervë                           | 2 500 milionë lekë;   |
| Fondi i kontingjencës                   | 2 730 milionë lekë;   |
| Fondi për rritjen e pagave dhe pensione | 4 278 milionë lekë.   |

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavarura nga Këshilli i Ministrave kufiri i shpenzimeve dhe numri i punonjësve janë sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në shpenzimet kapitale përfshihet edhe një fond kontingjence për mbështetjen e financimeve

të huaja prej 3 000 milionë lekësh, i cili shpërndahet nga Ministria e Financave, në përputhje me ecurinë e projekteve të huaja.

E drejta për të kryer shpenzime për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë nga fondi i përcaktuar në këtë ligj skadon më 31 maj 2011.

Fondi për kompensimin e energjisë elektrike përdoret sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave dhe shpërndahet nga Ministria e Financave.

Fondi i përfshirë në programin “Mbështetje për shoqërinë civile” përdoret për organizatat jofitimprurëse, sipas kriterëve ligjore, si dhe për mbulimin e kostos administrative.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet korrente, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si dhe për organet e pushtetit vendor.”.

Neni 10

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë në organikë në vitin 2010 është 90 000 veta. Këshilli i Ministrave përcakton numrin e punonjësve buxhetorë për çdo ministri dhe institucion qendror, me përjashtim të numrit të punonjësve të institucioneve të pavarura, që përcaktohen në tabelën 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave përcakton edhe numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme.

Për vitin 2010 nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore, me efekte financiare shtesë në buxhet, me përjashtim të institucioneve të reja të krijuara me ligj.”.

Neni 11

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Paga e Presidentit të Republikës është 250 000 lekë në muaj.”.

Neni 12

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave prej 2 500 milionë lekësh përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit prej 2 730 milionë lekësh dhe fondi për rritjen e pagave dhe të pensioneve prej 4 278 milionë lekësh përdoren me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 13

Tabela nr.3 dhe aneksi nr.3, që përmenden në nenin 15 të ligjit, zëvendësohen me tabelën dhe aneksin me të njëjtët numra, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 14

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Shtesa e stokut të borxhit deri në fund të vitit 2010 parashikohet të arrijë në 45 034 milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto për mbështetjen buxhetore, deri në 29 018 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 32 111 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 1 100 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra, të jashtme, të papaguara, është 1 675 milionë lekë.
5. Ulja e stokut të borxhit, si rezultat i rivlerësimit të valutës së Bankës së Shqipërisë, është 18 870 milionë lekë.”.

#### Neni 15

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

#### Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6662, datë 30.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

#### ANEKS 3

Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

I. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga:

- Granti konkurrues për infrastrukturën vendore;
- Granti konkurrues për arsimin bazë, parauniversitar dhe universitar;
- Granti konkurrues për shëndetësinë;
- Granti konkurrues për objektet kulturore;
- Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime;
- Granti konkurrues për ndërtim tregjesh agro-ushqimore dhe thertoresh;
- Granti konkurrues për ujitjen dhe kullimin;
- Granti konkurrues për pyllëzimin.

II. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përdoret për financimin e projekteve, të cilat ndodhen brenda territorit të njërive të qeverisjes vendore dhe zbatohen prej tyre.

III. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga:

- |                                                                 |         |
|-----------------------------------------------------------------|---------|
| 1. Kryeministri                                                 | Kryetar |
| 2. Ministri i Financave                                         | Anëtar  |
| 3. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës              | Anëtar  |
| 4. Ministri i Punëve Publike dhe Transportit                    | Anëtar  |
| 5. Ministri i Brendshëm                                         | Anëtar  |
| 6. Ministri i Arsimit dhe Shkencës                              | Anëtar  |
| 7. Ministri i Shëndetësisë                                      | Anëtar  |
| 8. Kryetari i Bordit të FSHZH                                   | Anëtar  |
| 9. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit | Anëtar  |
| 10. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve          | Anëtar  |
| 11. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave    | Anëtar  |
| 12. Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë               | Anëtar  |
| 13. Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë               | Anëtar  |
| 14. Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë                | Anëtar  |
| 15. Kryetari i Konferencës së Rektorëve                         | Anëtar. |

IV. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton projektet mbi bazën e politikave dhe programeve të zhvillimit të rajoneve të Shqipërisë.

V. Masa e kontributit/bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore përcaktohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

VI. Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke i dërguar projektet në:

- Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për objektet arsimore.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet shëndetësore.
- Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për objektet e ujësjellës-kanalizimeve.
- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për objektet ndërtim tregjesh agro-ushqimore, thertoresh dhe objekte për ujitje/kullim.
- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për objektet kulturore.
- Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

VII. Pranë Zyrës së Kryeministrit ngrihet Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Sekretariati i përgjithshëm administron dhe përgatit materialet për t'u diskutuar nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, duke analizuar projektet e investimeve, në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare e të programit politik të Qeverisë, si dhe i sugjeron Komitetit çështje për vendimmarrje.

VIII. Në ministritë përkatëse ngrihen sekretariate teknike, që bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe hartojnë një raport ku përshkruhet procedura e ndjekur, si dhe kriteret e zbatuara.

IX. Sekretariatet teknike të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera dërgojnë pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Financave dhe sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve listën e projekteve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore të shoqëruar me vlerësimet ekonomiko-teknike.

X. Këshillat e Qarqeve paraqesin pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve prioritetet e investimeve, sipas fushave përkatëse që mbulon Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, si edhe pjesën e bashkëfinancimeve me fonde vendore të fondeve të donatorëve.

XI. Ministria e Brendshme paraqet, pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, prioritetet e zhvillimit në nivel vendor, në përputhje me strategjitë e zhvillimit të qarqeve.

XII. Në rastin e projekteve në vazhdim me kontrata të lidhura, të cilat në bazë të realizimit me ritme të shpejta kanë mundësi absorbimi/realizimi të një vlere më të madhe se ajo e alokuar, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në një nga mbledhjet e tij të para, autorizon ministritë përkatëse të linjës për të propozuar pranë Ministrisë së Financave të drejtën e kalimit të fondeve në këto projekte, nga projektet që nuk e garantojnë realizimin e tyre apo edhe nga fonde të papërdorura. Projektet në vazhdim të infrastrukturës lokale dërgohen për vlerësim në FSHZH.

XIII. Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të fondeve të zhvillimit të rajoneve do të bëhet nga drejtoritë përkatëse në secilën nga ministritë përfituese. Për fondet e infrastrukturës vendore ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Raportet do të dërgohen në Ministrinë e Financave, sipas afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Zbatimit të Buxhetit.

XIV. Në lidhje me procedurat që ndiqen, ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e një udhëzimi.

XV. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për vendosjen e kriterëve për ndarjen e fondeve mes rajoneve.

Tab.1  
Buxheti i rishikuar i vitit 2010 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore  
në 000/lekë

| Kodi  | Emertimi i Institucionit / Programit                                 | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale |                 |                  |                        | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|-------|----------------------------------------------------------------------|------------------------|---------------------|-----------------|------------------|------------------------|--------------------------------|
|       |                                                                      |                        | Nga Buxheti         | Nga te Ardhurat | Financimi i Huaj | Totali i Shp. Kapitale |                                |
|       | Presidenca                                                           | 141,480                | 59,500              | 0               | 0                | 59,500                 | 200,980                        |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 57,470                 | 59,500              | 0               | 0                | 59,500                 | 116,970                        |
| 01120 | Veprimtaria e Presidentit                                            | 84,010                 | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 84,010                         |
| 2     | Kuvendi                                                              | 716,700                | 121,000             | 0               | 0                | 121,000                | 837,700                        |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 716,700                | 121,000             | 0               | 0                | 121,000                | 837,700                        |
| 3     | Keshilli Ministrave                                                  | 277,108                | 42,500              | 0               | 0                | 42,500                 | 319,608                        |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 277,108                | 42,500              | 0               | 0                | 42,500                 | 319,608                        |
| 4     | Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes                     | 1,006,960              | 308,200             | 0               | 1,540,905        | 1,849,105              | 2,856,065                      |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 287,960                | 35,000              | 0               | 0                | 35,000                 | 322,960                        |
| 04320 | Mbeshtetje per Energjiine                                            | 1,000                  | 45,000              | 0               | 373,000          | 418,000                | 419,000                        |
| 04430 | Mbeshtetje per Burimet Natyrore                                      | 184,000                | 160,000             | 0               | 0                | 160,000                | 344,000                        |
| 04440 | Mbesht. Miniera e Nd/je Publike                                      | 0                      | 0                   | 0               | 400,000          | 400,000                | 400,000                        |
| 04130 | Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik                                     | 253,600                | 37,200              | 0               | 462,905          | 500,105                | 753,705                        |
| 04160 | Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr. | 280,400                | 31,000              | 0               | 80,000           | 111,000                | 391,400                        |
| 04770 | Mbeshtetje per Zhvillim Rajonal                                      | 0                      | 0                   | 0               | 225,000          | 225,000                | 225,000                        |
| 5     | Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit        | 3,656,920              | 928,170             | 0               | 470,256          | 1,398,426              | 5,055,346                      |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                              | 213,000                | 52,000              | 0               | 0                | 52,000                 | 265,000                        |
| 04220 | Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit                        | 1,228,286              | 147,500             | 0               | 50,256           | 197,756                | 1,426,042                      |
| 04240 | Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes                  | 777,915                | 467,390             | 0               | 180,000          | 647,390                | 1,425,305                      |
| 04250 | Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.  | 1,212,619              | 230,757             | 0               | 240,000          | 470,757                | 1,683,376                      |
| 04860 | Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor                                 | 216,600                | 30,523              | 0               | 0                | 30,523                 | 247,123                        |
| 05470 | Menaxhimi qendrushem i tokes bujqesore                               | 8,500                  | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 8,500                          |

|       |                                                        |            |            |        |            |            |            |
|-------|--------------------------------------------------------|------------|------------|--------|------------|------------|------------|
| 6     | Ministria e Puneve Publike dhe Transportit             | 4,096,394  | 27,386,205 | 0      | 11,454,846 | 38,841,051 | 42,937,445 |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                | 308,695    | 2,800      | 0      | 0          | 2,800      | 311,495    |
| 04520 | Rrjeti i rrugeve nacionale                             | 1,355,178  | 21,889,505 | 0      | 6,956,000  | 28,845,505 | 30,200,683 |
| 04530 | Menaxhimi i Transportit                                | 24,301     | 0          | 0      | 0          | 0          | 24,301     |
| 04540 | Portet                                                 | 66,995     | 302,000    | 0      | 630,000    | 932,000    | 998,995    |
| 04550 | Hekurudhat                                             | 452,926    | 50,000     | 0      | 0          | 50,000     | 502,926    |
| 04560 | Aviacioni Civil                                        | 54,630     | 26,000     | 0      | 0          | 26,000     | 80,630     |
| 06370 | Ujesjelles Kanalizime                                  | 862,832    | 4,512,500  | 0      | 3,228,846  | 7,741,346  | 8,604,178  |
| 06180 | Strehimi dhe Urbanistika                               | 807,527    | 367,400    | 0      | 640,000    | 1,007,400  | 1,814,927  |
| 06220 | Sherbimet publike                                      | 163,310    | 236,000    | 0      | 0          | 236,000    | 399,310    |
| 10    | Ministria e Financave                                  | 5,806,296  | 329,489    | 0      | 160,000    | 489,489    | 6,295,785  |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                | 190,178    | 36,440     | 0      | 0          | 36,440     | 226,618    |
| 01120 | Menaxhimi i Shpenzimeve Publike                        | 483,169    | 3,900      | 0      | 0          | 3,900      | 487,069    |
| 01130 | Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme                      | 111,000    | 0          | 0      | 0          | 0          | 111,000    |
| 01140 | Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore                      | 1,951,058  | 105,000    | 0      | 0          | 105,000    | 2,056,058  |
| 01150 | Menaxhimi i te Ardhurave Doganore                      | 1,348,597  | 129,600    | 0      | 160,000    | 289,600    | 1,638,197  |
| 01160 | Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore      | 44,100     | 4,550      | 0      | 0          | 4,550      | 48,650     |
| 10270 | Menaxhimi i Sigurimeve Shoqerore                       | 1,615,000  | 49,999     | 0      | 0          | 49,999     | 1,664,999  |
| 01180 | Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike | 63,192     | 0          | 0      | 0          | 0          | 63,192     |
| 11    | Ministria e Arsimit dhe Shkences                       | 32,928,436 | 3,585,310  | 0      | 956,224    | 4,541,534  | 37,469,970 |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                | 872,807    | 24,034     | 0      | 10,000     | 34,034     | 906,841    |
| 09120 | Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)                 | 20,332,268 | 2,277,813  | 0      | 250,000    | 2,527,813  | 22,860,081 |
| 09230 | Arsimi i Mesem (i pergjithshem)                        | 4,197,216  | 565,796    | 0      | 204,400    | 770,196    | 4,967,412  |
| 09240 | Arsimi i Mesem (profesional)                           | 1,887,784  | 90,968     | 0      | 276,224    | 367,192    | 2,254,976  |
| 09450 | Arsimi Universitar                                     | 5,410,361  | 626,699    | 0      | 215,600    | 842,299    | 6,252,660  |
| 09770 | Fonde per Shkencen                                     | 228,000    | 0          | 0      | 0          | 0          | 228,000    |
| 12    | Ministria e Turizmit, Kulture, Rinise dhe Sporteve     | 1,537,980  | 172,000    | 0      | 373,851    | 545,851    | 2,083,831  |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                | 132,874    | 950        | 0      | 0          | 950        | 133,824    |
| 08220 | Trashegimia Kulturore dhe Muzete                       | 342,454    | 59,473     | 0      | 168,193    | 227,666    | 570,120    |
| 08230 | Arti dhe Kultura                                       | 657,774    | 109,769    | 0      | 0          | 109,769    | 767,543    |
| 08140 | Zhvillimi i Sportit                                    | 179,964    | 480        | 0      | 0          | 480        | 180,444    |
| 08170 | Programe per Rinine                                    | 52,480     | 0          | 0      | 0          | 0          | 52,480     |
| 04760 | Zhvillimi i Turizmit                                   | 90,654     | 1,328      | 0      | 205,658    | 206,986    | 297,640    |
| 08480 | Mbeshtetje per Kultet Fetare                           | 81,780     | 0          | 0      | 0          | 0          | 81,780     |
| 13    | Ministria e Shendetesise                               | 23,646,480 | 1,546,217  | 35,000 | 645,138    | 2,226,355  | 25,872,835 |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                | 198,100    | 43,968     | 0      | 0          | 43,968     | 242,068    |
| 07220 | Sherbimet e Kujdesit Paresor                           | 7,001,600  | 268,867    | 10,000 | 359,500    | 638,367    | 7,639,967  |
| 07330 | Sherbimet e Kujdesit Dytesor                           | 13,798,280 | 1,219,332  | 20,000 | 285,638    | 1,524,970  | 15,323,250 |
| 07450 | Sherbimet e Shendetit Publik                           | 2,648,500  | 14,050     | 5,000  | 0          | 19,050     | 2,667,550  |

Tab.1  
Buxheti i rishikuar i vitit 2010 sipas ministrive te linjës dhe institucioneve buxhetore  
në 000/lekë

| Kodi  | Emertimi i Institucionit / Programit                | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale |                 |                  |                        | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|-------|-----------------------------------------------------|------------------------|---------------------|-----------------|------------------|------------------------|--------------------------------|
|       |                                                     |                        | Nga Buxheti         | Nga te Ardhurat | Financimi i Huaj | Totali i Shp. Kapitale |                                |
| 14    | Ministria e Drejtesise                              | 4,965,720              | 357,030             | 0               | 510,000          | 867,030                | 5,832,750                      |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi             | 243,579                | 23,130              | 0               | 0                | 23,130                 | 266,709                        |
| 01120 | Publikimet Zyrtare                                  | 47,590                 | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 47,590                         |
| 01130 | Mjekesia Ligjore                                    | 39,070                 | 4,000               | 0               | 0                | 4,000                  | 43,070                         |
| 03440 | Sistemi i Burgjeve                                  | 3,408,604              | 296,870             | 0               | 450,000          | 746,870                | 4,155,474                      |
| 03350 | Sherbimi i Permbartimit Gjyqesor                    | 158,960                | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 158,960                        |
| 01160 | Sherbimet per cështjet e biresimeve                 | 13,020                 | 300                 | 0               | 0                | 300                    | 13,320                         |
| 01170 | Sherbimi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme  | 546,100                | 18,600              | 0               | 60,000           | 78,600                 | 624,700                        |
| 01180 | Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave       | 457,720                | 5,000               | 0               | 0                | 5,000                  | 462,720                        |
| 03490 | Sherbimi i Proves                                   | 51,077                 | 9,130               | 0               | 0                | 9,130                  | 60,207                         |
| 15    | Ministria e Puneve te Jashtme                       | 1,932,320              | 77,000              | 0               | 0                | 77,000                 | 2,009,320                      |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi             | 55,962                 | 4,000               | 0               | 0                | 4,000                  | 59,962                         |
| 01120 | Perfaqesite Diplomatike                             | 1,629,088              | 70,000              | 0               | 0                | 70,000                 | 1,699,088                      |
| 01130 | Promovimi i imazhit te vlerave te vendit            | 120,430                | 1,000               | 0               | 0                | 1,000                  | 121,430                        |
| 01140 | Integrimi europian dhe euro-atlantik                | 126,840                | 2,000               | 0               | 0                | 2,000                  | 128,840                        |
| 16    | Ministria e Brendshme                               | 15,408,041             | 860,400             | 0               | 724,888          | 1,585,288              | 16,993,329                     |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi             | 662,480                | 11,297              | 0               | 10,658           | 21,955                 | 684,435                        |
| 01330 | Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike     | 75,580                 | 1,115               | 0               | 0                | 1,115                  | 76,695                         |
| 03140 | Policia e Shtetit                                   | 10,321,640             | 795,232             | 0               | 714,230          | 1,509,462              | 11,831,102                     |
| 03150 | Garda e Republikes                                  | 1,194,000              | 1,409               | 0               | 0                | 1,409                  | 1,195,409                      |
| 01160 | Prefekturat dhe Funksionet e Deleguara te P. Vendor | 614,600                | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 614,600                        |
| 01170 | Sherbimi i Gjendjes Civile                          | 696,030                | 48,994              | 0               | 0                | 48,994                 | 745,024                        |

|       |                                                                |            |           |         |         |           |            |
|-------|----------------------------------------------------------------|------------|-----------|---------|---------|-----------|------------|
| 01180 | Menaxhimi i Rezervave te Shtetit                               | 176,010    | 2,353     | 0       | 0       | 2,353     | 178,363    |
| 10910 | Emergjencat Civile                                             | 1,667,700  | 0         | 0       | 0       | 0         | 1,667,700  |
| 17    | Ministria e Mbrojtjes                                          | 16,158,090 | 3,484,972 | 100,000 | 6,286   | 3,591,258 | 19,749,348 |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 1,131,479  | 45,000    | 0       | 0       | 45,000    | 1,176,479  |
| 02120 | Forcat e Luftimit                                              | 5,473,173  | 2,798,722 | 0       | 0       | 2,798,722 | 8,271,895  |
| 09430 | Arsimi Ushtarak                                                | 1,089,802  | 116,150   | 0       | 0       | 116,150   | 1,205,952  |
| 07340 | Mbeshtetje Shendetesore                                        | 574,742    | 20,000    | 0       | 6,286   | 26,286    | 601,028    |
| 02150 | Mbeshtetja e Luftimit                                          | 3,791,831  | 248,400   | 100,000 | 0       | 348,400   | 4,140,231  |
| 02160 | Mbeshtetja e Pergendruar                                       | 384,261    | 239,600   | 0       | 0       | 239,600   | 623,861    |
| 10270 | Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket                              | 2,920,000  | 0         | 0       | 0       | 0         | 2,920,000  |
| 02280 | Bashkepunimi Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC)                      | 792,802    | 17,100    | 0       | 0       | 17,100    | 809,902    |
| 18    | Sherbimi Informativ Shtetror                                   | 1,147,323  | 98,000    | 0       | 0       | 98,000    | 1,245,323  |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 364,439    | 98,000    | 0       | 0       | 98,000    | 462,439    |
| 03520 | Veprimtaria Informative Shtetore                               | 782,884    | 0         | 0       | 0       | 0         | 782,884    |
| 19    | Drejtoria e Radio Televizionit                                 | 364,260    | 65,000    | 0       | 0       | 65,000    | 429,260    |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 0          | 0         | 0       | 0       | 0         | 0          |
| 08320 | Veprimtaria Radiotelevizive e RTSH-se                          | 364,260    | 65,000    | 0       | 0       | 65,000    | 429,260    |
| 20    | Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave                            | 164,660    | 13,000    | 0       | 0       | 13,000    | 177,660    |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 164,660    | 13,000    | 0       | 0       | 13,000    | 177,660    |
| 22    | Akademia e Shkences                                            | 81,790     | 1,000     | 0       | 0       | 1,000     | 82,790     |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 8,896      | 1,000     | 0       | 0       | 1,000     | 9,896      |
| 01520 | Veprimtaria Akademike                                          | 72,894     | 0         | 0       | 0       | 0         | 72,894     |
| 24    | Kontrolli Larte i Shtetit                                      | 265,740    | 7,500     | 0       | 0       | 7,500     | 273,240    |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 42,474     | 7,500     | 0       | 0       | 7,500     | 49,974     |
| 01120 | Veprimtaria Audituese e KLSH                                   | 223,266    | 0         | 0       | 0       | 0         | 223,266    |
| 25    | Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta | 49,515,770 | 110,950   | 5,000   | 0       | 115,950   | 49,631,720 |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 137,810    | 20,000    | 0       | 0       | 20,000    | 157,810    |
| 10220 | Sigurimi Shoqror                                               | 28,407,824 | 0         | 0       | 0       | 0         | 28,407,824 |
| 10430 | Mbrojtja Sociale                                               | 19,268,476 | 5,000     | 0       | 0       | 5,000     | 19,273,476 |
| 10550 | Tregu i Punes                                                  | 1,533,460  | 65,750    | 5,000   | 0       | 70,750    | 1,604,210  |
| 04170 | Inspektimi ne Pune                                             | 150,660    | 18,500    | 0       | 0       | 18,500    | 169,160    |
| 10460 | Shanset e Barabarta                                            | 17,540     | 1,700     | 0       | 0       | 1,700     | 19,240     |
| 26    | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave       | 1,116,700  | 140,000   | 50,000  | 444,720 | 634,720   | 1,751,420  |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 74,000     | 10,000    | 0       | 0       | 10,000    | 84,000     |
| 05320 | Programe per mbrojtjen e Mjedisit                              | 107,000    | 28,019    | 0       | 291,720 | 319,739   | 426,739    |
| 04230 | Mbeshtetje per Peshkimin                                       | 70,000     | 23,150    | 0       | 30,000  | 53,150    | 123,150    |
| 05640 | Administrimi i Ujrave                                          | 30,600     | 0         | 0       | 0       | 0         | 30,600     |
| 04260 | Administrimi i Pyjeve                                          | 835,100    | 78,831    | 50,000  | 123,000 | 251,831   | 1,086,931  |
| 28    | Prokuroria e Pergjithshme                                      | 1,121,960  | 113,855   | 0       | 0       | 113,855   | 1,235,815  |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                        | 1,121,960  | 113,855   | 0       | 0       | 113,855   | 1,235,815  |

Tab.1  
Buxheti i rishikuar i vitit 2010 sipas ministrive tE linjës dhe institucioneve buxhetore  
në 000/lekë

| Kodi  | Emertimi i Institucionit / Programit              | Totali i Shp. Korrente | Shpenzimet Kapitale |                 |                  |                        | Totali i Shpenzimeve Buxhetore |
|-------|---------------------------------------------------|------------------------|---------------------|-----------------|------------------|------------------------|--------------------------------|
|       |                                                   |                        | Nga Buxheti         | Nga te Ardhurat | Financimi i Huaj | Totali i Shp. Kapitale |                                |
| 29    | Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor            | 1,479,880              | 180,000             | 0               | 0                | 180,000                | 1,659,880                      |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi           | 27,900                 | 500                 | 0               | 0                | 500                    | 28,400                         |
| 03310 | Buxheti Gjyqesor                                  | 1,451,980              | 179,500             | 0               | 0                | 179,500                | 1,631,480                      |
| 30    | Gjykata Kushtetuese                               | 94,280                 | 5,000               | 0               | 0                | 5,000                  | 99,280                         |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi           | 38,650                 | 5,000               | 0               | 0                | 5,000                  | 43,650                         |
| 03320 | Veprimtaria Gjyqesore Kushtetuese                 | 55,630                 | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 55,630                         |
| 31    | Agjensia Telegrafike Shqiptare                    | 88,380                 | 5,000               | 0               | 0                | 5,000                  | 93,380                         |
| 01110 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi           | 30,878                 | 5,000               | 0               | 0                | 5,000                  | 35,878                         |
| 08320 | Veprimtaria Telegrafike e ATSH-se                 | 57,502                 | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 57,502                         |
| 40    | Partite Politike                                  | 212,000                | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 212,000                        |
| 01110 | Mbeshtetje per Partite Politike                   | 199,000                | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 199,000                        |
| 01120 | Mbeshtetje per Shoqatat                           | 10,000                 | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 10,000                         |
| 01130 | Mbeshtetje per Organizatat e Veteraneve me Status | 3,000                  | 0                   | 0               | 0                | 0                      | 3,000                          |
| 50    | Instituti Statistikes                             | 367,300                | 10,000              | 0               | 10,000           | 20,000                 | 387,300                        |
| 01310 | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi           | 164,053                | 10,000              | 0               | 10,000           | 20,000                 | 184,053                        |
